REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SARANDË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 7994/12 Prot.

Sarandë, më 5.11.2025

PROÇESVERBAL

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Sarandë që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 12:00
Data e mbajtjes së mbledhjes : 31.10.2025
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Sarandë: N/Kryetar i Bashkisë Z.Florjan Sali dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen.

Marrin pjesë :

1. Asaf Stroka
2. Gjergji Imeraj
3. Festim Mina
4. Zana Piro
5. Kevin Alikaj
6. Klejdjan Murtaj
7. Laureta Çeçi
8. Vesel Koçiu
9. Ilva Qëndro
10. Dritan Peçi
11. Enea Vasili
12. Denisa Islamaj
13. Përparim Ahmeti
14. Pranvera Osmani
15. Shpëtim Ahmeti
16. Thanas Gurma
17. Lindita Kondi
18. Ilirjan Gërdhuqi

Mungojnë :

19. Xhino Jaçaj
20. Ibrahim Bajrami
21. Angjele Lapa
22. Indi Rrapaj
23. Bejdo Çela
24. Anjeza Dike
25. Eugen Qëndro
26. Farie Hyska
27. Elona Mano
28. Katerina Beqo
29. Ermir Hoxha
30. Dafina Allkushi

Asaf Stroka : Përshëndetje !
Të nderuar Anëtarë të Këshillit Bashkiak! I nderuar Zv/Kryetar i Bashkisë!Të nderuar pjesëmarrës dhe përfaqësues të medias !
Zhvillojmë mbedhjen e Këshillit Bashkiak datë 31.10.2025, vijojmë bazuar në ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" neni 53, çdo fillim mbledhje miratohet rendi i ditës sipas thirrjes për zhvillimin e mbledhjes sipas rendit si më poshtë:

1. **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Shtator 2025".

2. **P/vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shtator 2025".

3. **P/vendim**"Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë nr.72, datë 23.12.2024".

4. **P/vendim**"Për miratimin e shembjes së godinës e cila shërbenpër kopshtit nr.4 Sarandë, pjesë e godinës së shtëpisë së fëmijës"Vangjel Pulla", pasuri në pronësi të Bashkisë Sarandë, për qëllim ndërtimin e godinës së re të kopshtit ".

5. **P/vendim**"Për miratimin e ndryshimit të pjesshëm të destinacionit për sipërfaqen 1347 m^2, pjesë e pasurisë 17/322/1 zona kadastrale 8641 "truall" në pronësi të Bashkisë Sarandë, duke shtuar fushën e përdorimit dhe arsimin parashkollor ".

6. **P/vendim** " Për korrigjimin e gabimeve materiale".

7. Gjendjen e rrugëve në fshatin Gjashtë – Sarandë, si rezultat i punimeve nga ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizime.

8. Analizë e mbarëvajtjes së sezonit turistik 2025.

9. Raport i Drejtorisë së Shërbimeve Publike lidhur me lejet për vendparkime të rezervuara .

10. Raport mbi performancën e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Gjergji Imeraj: Propozoj të shtohet në rendin e ditës projektvendimi "Për emërtimin e parkut të fëmijëve " Motër Daniela Silvestrin" ndodhur në lagjen nr.4 Sarandë"

Asaf Stroka: Hedhim në votim rendin e ditës me propozimin e bërë nga zoti.Imeraj

Miratohet me 18 vota pro rendi i ditës me propozimin e bërë nga Z.Imeraj.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e parë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për ndihmën ekonomike deri në 6 % për muajin Shtator 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 1 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 18 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: **P/vendim** "Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë për muajin Shtator 2025".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 2 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 18 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tretë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Sarandë nr.72, datë 23.12.2024".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 3 të rendit të ditës, kemi ndonjë pyetje nga ana e këshilltarëve?

Vesel Kociu : Pyetja pare, cili do të jetë destinacioni i këtij sheshi, përse do të përdoret? Dhe pyetja e dytë, nëse ka probleme me persona të tretë të cilët mund të kenë kontrata ndërmjet sipërmarrësve, tani nderyhet, por që mund të mos e kenë përfunduar procesin e regjistrimit me hipotekën.

Garufo Koka:. Ky projektvendim është në cilësitë e trajtimit të parë që ne kemi pasur. Pas korrespondencës me entin kombëtar të banesave lind nevoja që sipërfaqja të jetë më e madhe për most u krijuar ajo hapësira midis dy sipërfaqeve që ishin të evidentuara. Nga ana e drejtorisë së planifikimit të drejtorit është e evidentuar gjithë sipërfaqja dhe siç shikoni bashkëlidhur projektvendimit kemi formularët që plotësohen dhe është kërkesë e ligjit ku fusha e përdorimit është e përcaktuar aty. Gjithashtu për sa i përket evidentimit në qoftë se krijon përplasje me vendimmarrjen e mëparshme nga drejtori i urbanistikës është konfirmuar që është një sipërfaqe e cila nuk është e shpërndarë me vendimet e Këshillit Bashkiak por edhe sikur të ndodhë ajo përsëri do jetë në pronësi të Bashkisë Sarandë dhe nuk do ketë asnjë lloj pengese për të krijuar një sipërfaqe pasardhje.

Shpëtim Ahmeti : Kaloi një vit dhe u perbetuat se do kalonin fondet për strehimin Edhe më. Mos të gaboj po nuk gaboj fare dhe sot të shtojmë sipërfaqja është e çudishme, por do të jemi këtu në këshill prapë që më duket sepse është një projektvendim abuziv, shtimi i sipërfaqes mesa shoh nuk është për banesa e gjithë zhurma është për troje për tu shitur.

Vesel Kociu : Tek projektvendimi nuk përcaktohet përse do të përdoret , thotë thjesht për infrastrukturë.

Garufo Koka : Është është e shprehur te relacioni bashkangjitur projektvendimit , te paragrafi tretë, rreshti i dytë.

Ilir Gërdhuqi ; Unë dua të diskutojë se është e papranueshme që mos kemi një përfaqësues këtu nga zyra e urbanistikës. doja të pyesja domethënë duke qenë duke qenë se ju thoni është pozicioni mbi stadiumin domethënë nëpërmjet stadiumit e rrugës të pestë ta quajmë apo mbi rrugën e pestë. Nuk marrim dot një përgjigje, ku ndodhet konkretisht. Duhej një përfaqësues të pyetje të na sqaronte pak se ne s'jemi as inxhinierë as hartograf.

Asaf Stoka: që ky është një projektvendim dhe kjo sipërfaqe shkon për banesa sociale kjo është e padiskutueshme se ne nuk mund të shtrembërojmë diçka që e kemi të caktuar këtu e shkruar shprehimisht që kjo sipërfaqe shkon për banesa sociale. Për sa i përket pjesës së drejtorisë së urbanistikës, në qoftë se ne i referohemi materialit të ardhur ka një plan rilendimi dhe është e përcaktuar konkretisht se ku bie kjo sipërfaqe por. Edhe tek relacioni shpjegues kjo është një një sipërfaqe e cila është e miratuar me studimin me studimin e mëparshëm të bashkisë pra është një sipërfaqe e miratuar në studim me këtë destinacion dhe sot vjen mundësia që të shtohet sipërfaqe për të shtuar sa më tepër banesa sociale.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 1.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e katërt të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e shembjes së godinës e cila shërbenpër kopshtit nr.4 Sarandë, pjesë e godinës së shtëpisë së fëmijës"Vangjel Pulla", pasuri në pronësi të Bashkisë Sarandë, për qëllim ndërtimin e godinës së re të kopshtit ".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 4 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Shpëtim Ahmeti : cfarë do bëhet me shtëpinë e fëmijës realisht?

Garufo Koka : atëherë pjesë të projektvendimit kemi të gjithë materialet teknikë që kemi pasqyron saktë gjendjen e godinës aktualisht domethënë sipërfaqja e cila do të prishet dhe që sot përdoret për në shërbim të kopshtit numër katër dhe e cila ka një sipërfaqe 489 m katrorë. Ajo është e pasqyruar saktë tek planvendosja pjesë përbërëse e këtij projektvendimi . Kopshti kanë nisur funksionin e saj pa asnjë lloj vendimmarrjeje nga ana e këshillit bashkiak dhe sot aktualisht ajo shërben si Kopësht por nuk kemi një vendimmarrje për të rregulluar këtë pjesë. duke qenë se godina do të shembet pjesa e sipërfaqes së truallit e cila do shërbejë për të zhvilluar ndërtimin e. Kopështit të ri dhe ambienteve përreth tij do të jetë kjo sipërfaqe prej 1347 m katrorë. Shtëpia e fëmijës do të jetë e paprekur.

Shpëtim Ahmeti : Atje do ndërtohet vetëm kopshti numër katër apo ndërtohet një godinë që do të mblidhen të gjithë kopshtet?

Garufo Koka : jo, është kjo është projekti i bashkisë, është kopësht.

Gjergji Imeraj : Në çfarë faze është leja e ndërtimit ose e fillimit të investimit në qoftë se këshilli bashkiak sot e miraton? Sepse ne na intereson ecuria më tej. Për sa kohë bashkia do fillojë shembjen dhe fillimin e investimit.

Garufo Koka : Nëse keni dijeni, atëherë projekti i investimit është në fazë projektimi. Është projektuar, ka kaluar dhe është në fazën e hapjes së aktit të ekspertizës që bëhet nga Ministria e Financave. Pasojat ligjore kanë rezultuar që nuk ka rrezikshmëri për sa i përket strukturës së vetë. Prandaj lind nevoja që ne të marrim vendimmarrje të shembet kjo si godinë mbi bazën e ekspertizës së ardhur. E keni të cituar dhe datën ligjore dhe pjesë përbërëse të këtij projektvendimi. Më tej, pas miratimit nga ana juaj, do të kryhet procedura për aplikim për lejen e ndërtimit të cilën do ta japi Bashkia sarandë.

Gjergji Imeraj : Dhe kush do jetë financuesi? Bashkia apo qeveria?

Garufo Koka : Financues është qeveria qendrore.

Vesel Koçiu : Do të thosha që do të ishte mirë që bashkia e Sarandës, përpara se të bëjë këtë projektvendim për miratim, duhet të kishte marrë miratimin nga ministria e lidhjes për ndryshimin e destinacionit sepse destinacioni i sheshit aktualisht ka një funksion edhe social për ekspertizë të fëmijës. Dhe pasi kishte marrë ky vendim nga ministria e lidhjes dhe kishte kthyer përgjigje bashkisë Sarandë, atëherë kishte mundur të merrte një vendim për prishjen e kësaj pjese. Megjithatë, kjo nuk na pengon që ta votojmë. Patjetër, po them që të hajë kohë pas kësaj të merret miratimi nga ministria e lidhjes për ndryshim destinacioni.

Hir Gërdhuqi : Unë mendoj që ai kopsht është ekzistues, nuk ka asnjë problem dhe atje aktualisht shërbejnë dy: është dhe drejtoria e ndërmarrjes së shërbimeve, kështu që ajo do të spostohet. Bëhet fjalë për pjesën nga mbrapa se unë jam i interesuar dhe është diçka shumë e mirë. Unë e mbështes, unë do ta mbështes me gjithë dëshirën të bëhet, se ne kemi nevojë sa më shumë investime për pjesën e kopshteve edhe të shkollave. Kuptohet kështu që ajo pjesa që është sa duhet të ishte ndërmarrja e shërbimeve do i kthehet, do i jepet kopshtit për të krijuar një fushë për kalamajtë edhe pjesa tjetër. Kështu që mendoj se nuk cënohet shtëpia e fëmijës, se ashtu ka funksionuar dhe atë pjesë që kërkon prapë rindërtimi i kopshtit, atë pjesë do ketë thjesht i shtojnë hapësirat për zbavitjen e fëmijëve. Kështu që personalisht e mbështes edhe uroj që kolegët ta mbështesin.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 1.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e pestë të rendit të ditës: **P/vendim** "Për miratimin e ndryshimit të pjesshëm të destinacionit për sipërfaqen 1347 m^2, pjesë e pasurisë 17/322/1 zona kadastrale 8641 "truall" në pronësi të Bashkisë Sarandë, duke shtuar fushën e përdorimit dhe arsimin parashkollor **".**

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 5 të rendit të ditës, kemi ndonjë koment nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohet me 17 vota pro, abstenim 0, kundër 1.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e gjashtë të rendit të ditës: **P/vendim** " Miratim i korrigjimit të gabimeve materiale".

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 6 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimet një nga një

Miratohen me 18 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me projektvendimin shtesë: **P/vendim** "Për emërtimin e parkut të fëmijëve " Motër Daniela Silvestrin" ndodhur në lagjen nr.4 Sarandë"

Asaf Stroka: kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Hedhim në votim projektvendimin.

Miratohen me 18 vota pro, abstenim 0, kundër 0.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e shtatë të rendit të ditës

Gjendjen e rrugëve në fshatin Gjashtë – Sarandë, si rezultat i punimeve nga ndërmarrja Ujësjellës-Kanalizime.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 7 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e tetë të rendit të ditës

Analizë e mbarëvajtjes së sezonit turistik 2025.

Nuk ka komente, diskutime.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e nëntë të rendit të ditës

Raport i Drejtorisë së Shërbimeve Publike lidhur me lejet për vendparkime të rezervuara .

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 9 të rendit të ditës, kush ka pyetje nga ana e këshilltarëve?

Dritan Peçi : Kjo është një nga pikat më të ndjeshme në qytetin tonë. E kemi diskutuar dhe ridiskutuar qindra herë këtë pjesë të parkimeve. Gjithsesi, unë me dy fjalë do ja pyesja drejtorinë përkatëse në qoftë se të gjitha ato parkimet që janë të vizuara bashkë me faturat që janë depozituar në bashkinë Sarandë përputhen. Aq parkime sa janë vizuar në qytet. Me faturat që janë prerë për këto parkime që janë vizuar dhe pjesa tjetër që është prapë. Shumë problem është pse duhet të bëjmë të gjithëve nga dy nga tre parkime kur kanë, e kemi thënë dhe rithënë prapë, kur kanë motora me qira, makina me qira. Biznese që nga unw I pari e të gjithë me radhë. Domethënë, duhet të jemi pak më të rezervuar te kjo pjesë, se ne jemi një qytet që kemi mbi popullin në bazë të rrugëve që ne disponojmë dhe kemi shumë probleme me parkimin. Prandaj do t'ju lutesha të jeni më të rezervuar te dhënia me qira e parkimeve. Pra, pyetja e para dhe e dyta ishte si sugjerim. Shumë faleminderit.

Joli Dine : Në lidhje me situatën e parkimeve të rezervuar në qytetin e Sarandës dhe në Ksamil. Unë ju kam vënë në dispozicion një raport të shërbimeve publike. E vërteta është që situata e parkimeve ka qenë gjithmonë problematike dhe nuk është vetëm për këtë vit. Po flasim për vitet e kaluara, ku siç e keni vënë re, qytetarë dhe bizneset kanë kërkuar vazhdimisht të mbajnë parkimet e rezervuara, duke vendosur arka, shishe plastike apo sende të tjera të cilat nuk janë të përcaktuara në rregulloren e rezervimit të një parkimi. Në bashkëpunim me policinë bashkiake, kemi shtuar patrulla të vazhdueshme. Nga ana e drejtorisë sonë, ndryshe nga më parë, edhe ne

kemi ngritur grupe pune për kontrolle ditore periodike gjatë javëve përgjatë muajve për situatën e parkimeve në qytet. Kemi vendosur shumë raste, pafund raste, ku përveç pjesës së vendosjes së sendeve. Janë vizuar sipërfaqe e rrugëve për të mbajtur në anë të bizneseve apo individëve si parkim i rezervuar. Për të dalë pastaj tek ato që tha zoti Peçi, që në qoftë se përputhen të gjitha vizimet e veta me faturat që janë të rregjistruara pranë drejtorisë së shërbimeve publike në bashkinë Sarandë. Po të dalësh në kontroll. Gjithmonë vë në re që nuk ka përputhje të parkimeve të dhëna nga ana jonë dhe parkimet faktike dhe për rrugën. Tani, kontrolli i territorit është i vazhdueshëm dhe ka raste ku gjatë natës individë të caktuar kanë kryer vizime të cilat janë si ajo fotografia që e kemi publikuar dje portali saranda web, që parkimi i dhënë nga ana jonë ishte i vizuar nga ndërmarrja në formate të përcaktuara dhe parkimi që vazhdonte në tej ishte një parkim, një vizim i shtrembër. Nga ana jonë ku janë evidentuar raste të tilla, jemi zgjuar në mëngjes dhe kemi parë të tilla vizime. Kemi njoftuar strukturat përkatëse dhe drejtoria jonë, policinë bashkiake dhe ndërmarrjen e shërbimeve për penalizimin e subjektit që i ka kryer, identifikimin e tij dhe pastaj edhe fshirjen e vizimeve të tilla. Sigurisht që në rastet ku janë konstatuar sende, është menaxhuar menjëhershme nga ana e policisë bashkiake dhe pastaj penalizimin e subjektit. Kemi parë lloj-lloj veprimesh nga ana e subjekteve për mbajtjen e këtyre parkimeve. Është një situatë shumë e ndjeshme, e dimë ndjeshmërinë që kanë dhe bizneset edhe individët. Për këtë problem dhe vazhdimisht jemi duke kontrolluar dhe monitoruar cdo subjekt apo çdo territor të bashkisë për këto vendparkime që mbajnë. Për t'u shfrytëzuar më pas si nga individët, por edhe nga bizneset. Ka dhe raste brenda rrugicave të lagjeve që shfrytëzohen në mënyrë të paligjishme dhe të gjitha rastet janë evidentuar, janë penalizuar më pas konform ligjit. Kuptohet që kontrolli i territorit është i vështirë, sepse është territor i gjërë, e kam shënuar problematikat që kemi ne si drejtori për këtë çështje. Po mundohemi të bëjmë më të mirën sa i përket kësaj situate. Unë dua të them që, në një pikë të raportit që unë ju kam vënë në dispozicion. Ju shikoni që drejtoria e shërbimeve publike ka arritur të ardhur në bashkinë Sarandë në masën 48.7%. Unë ju siguroj që të gjitha këto parkime të reja, të cilat ne kemi arritur të vjelim të ardhura në vitin 2025, kanë qenë parkime të zaptuara më parë, të zaptuara ndoshta me këto sende që thashë apo me vizime të paligjshme dhe duke pasur këtë presionin e kontrollit nga ana jonë dhe nga ana e policisë bashkiake, dhe duke pasur një evidentim më të mirë nga ana jonë të subjekteve të cilat duan të pajisemi me parkimin, kemi arritur që atë që dje, ata e mbajnë në mënyrë të paligjshme dhe bashkia nuk arrinte tw vilte dhe të ardhur nga ai parkim. Sot ne i kemi të administruar drejtorinë tonë, të evidentuara dhe me të ardhura të tjera të paguara nga ana e subjekteve. Ndaj dhe nga ana jonë, të paktën për fillimin e anë të hënës, janë arkëtuar deri tani 9.75 milionë të reja nga 6.105 milionë që kanë qenë një vit më parë. Pra, të ardhurat janë 48.7%. Sa i përket asaj, ju tha zoti Peçi, që duhet të themi më të rezervuar, normalisht edhe ne e kemi këtë shqetësim.Normalisht për çdo subjekt që kërkon edhe analizë tonën, se ai takon këtij subjekti, si të thuash. Të ketë një apo dy parkime apo tre. Dhe e kemi parë rast pas rasti këtë situatë dhe kërkesat e tyre, domethënë, janë analizuar nga ana jonë me qëllim që dhe ne mos të kemi pengesa si subjekteve të tjera, por edhe banorëve. Domethënë, në çdo rast që te ne vjen një kërkesë për të pajisur me parkim të rezervuar, në të gjitha rastet ai parkim nuk është dhënë nga zyra. Por specialisti i drejtorisë së shërbimeve publike ka shkuar në vend, e ka evidentuar, ka parë problematikën. Kemi pasur dhe raste ku ne kemi refuzuar për shkak të faktit që banorët nuk kanë qenë dakort me atë subjekt që të ketë një parkim. Ashtu sikundër kemi pasur edhe raste kur

kemi revokuar parkimin. Për nga pas raste që neve kemi pajisur, po them, një individ apo një subjekt me parkim dhe pastaj nga monitorimi i vazhdueshëm që kemi bërë, kemi hasur problematika dhe kemi proceduar më pas me revokimin e atij parkimi. Kështu që jemi dhe ne, siç jemi dhe ju, shumë të ndjeshëm ndaj kësaj.

Kevin Alikaj : Të gjithë këshilltarët që janë këtu, edhe përfaqësuesit e bashkisë, ky raport me këto parkimet e paguara ose edhe të invalidëve nuk na jep atë pasqyrën që kemi parë në vendet e huaj që neve shkojmë. Sepse në qoftë se vemi çdo biznes të marrin nga një vend parkimin, po e zë unë se edhe sikur ta racionojë bashkia në një, aq janë rrugët e Sarandës dhe këta turistët që neve do sjellim, që do sjellim të ardhura, dhe biznesit në qytetin tonë dështojnë duke mos gjetur, sepse unë kam biznesin tim, kam një vend parkimi. Zotëria ka një biznes ngjitur në krah, ka një vend parkimi, se kështu ka mbajtur dhe të gjithë këta qytetarët që neve, po na vijnë turistët ose qoftë edhe dikush që do të shkojë për të mbaruar një punë në një zyrë, nuk ka. Invalidët në Sarandë vjen një invalid nga një rreth tjetër ose turist me makinën e vet. Parkimet e invalidëve në asnjë vend të botës nuk janë të dedikuara për individ, qeverinë ose dikë tjetër. Parkimet janë të lëvizshme. Parkova unë tani, mbarova punë, ika, vjen, parkon tjetri. Dhe nuk mundet një qytet i tërë të penalizohet vetëm nga kjo pjesa e parkimeve dhe ka ndodhur edhe sherre, siç jemi në dijeni të tërë për parkimet jo ti, jo unë. Duhet të marrin masa bashkia, ta ndërpresë këtë filmin në gjithë vendet e botës dhe lejet e parkimeve. Mbasi ke marrë lejet e pallatit, sepse ka shumë pjesë hyrjesh garazhesh. Në qoftë se ti ke bërë një objekt dhe ke marrë një leje ndërtimi, ke paraqitur një projekt pranë bashkisë dhe të ka miratuar hyrje garazhi në atë pozicion, mund t'i vendosë bashkia një tabelë në bazë të lejes së ndërtimit, numër kaq të lejohet kjo hyrje, sepse ka shumë njerëz që thonë: "Mos ma zë rrugën mua, se kam do kaloj unë këtu, ndërkohë që ai nuk e ka brenda lejes atë hyrjen që ka aty." Dhe këto kanë sjellë shumë problematika. Bashkia duhet ta mendojë shumë mirë këtë pjesë edhe neve si këshilltarë duhet t'i shikojmë këtë pjesën, jo të tolerojmë, sepse do rrimë vetë në rrugë dhe këta turistët që do na vijnë nuk vijnë më prapë këtu, se s'kanë ku të parkojnë. Mund të supozojmë që të vendoset një taksë 1.000 lek për një makinë me një bankomat, siç e bëjnë gjithë bota, të bëhet një investim që është shumë i thjeshtë për t'u realizuar, ose një mesazh siç e kishte realizuar në Tiranë bashkia e Tiranës. Dhe është shumë më praktike.

Asaf Stroka: Vijojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës

Raport mbi performancën e Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

Asaf Stroka: Për sa i përket pikës 10 të rendit të ditës, raporti nuk ka ardhur nga administrata, do shtyhet per mbledhjen e rradhes.

Asaf Stroka : Duke ju falenderuar , e deklaroj mbledhjen të mbyllur.

Ky proçesverbal mbyllet me nr.rendor 10 (dhjetë) fletë, i cili pasi verifikohet firmoset nga kryetari i këshillit, sekretari i këshillit dhe komisioni i verifikimit të procesverbalit.

Mbajtësi i proçesverbalit: Valbona Vasili

Komisioni i Verifikimit të Proçesverbalit :

1.	Kryetar i Këshillit Bashkiak :	Asaf Stroka
2.	Partia Socialiste e Shqipërisë:	Lindita Kondi
3.	Partia,Drejtësi,Integrim dhe Unitet:	Klejdjan Murtaj
4.	Partia Balli Kombëtar:	Bejdo Çela
5.	Partia Republikane Shqiptare :	Përparim Ahmeti
6.	Fryma e Re Demokratike:	Ilir Gërdhuqi
7.	Kryetar i Grupit Bashkë Fitojmë:	Shpëtim Ahmeti
8.	Kryetar i Grupit Partia Demokratike:	Vesel Koçiu
9.	Aleanca Arbnore Kombëtare:	Xhino Jaçaj
10.	I pavarur	Kevin Alikaj